



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.156/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar Enis Ajvazi nga Gjermania, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.08.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet i pabazuar** apeli i paraqitur nga Enis Ajvazi nga Gjermania, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën **23.08.2021** PZAP-i ka pranuar një apel nga Enis Ajvazi nga Gjermania, në të cilën pretendohet se i plotëson kriteret për votim jashtë Kosovës.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur KQZ, me të cilën ka theksuar se ka dërguar vetëm dokumentin e huaj të identifikimit, duke dëshmuar identitetin. Por nuk ka asnjë dokumenti me të cilin do të vërtetohej kriteri ligjor për tu përfshirë si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

#### Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: **“çdo person ka të drejt për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”**. Në rastin konkret në shkresat e lëndës gjendet vendimi i datës 12.09.2019, i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, me të cilin vendim Enis Ajvazi lirohet nga Shtetësia e Republikës së Kosovës. Me këtë vendim i njëjti e hubë të drejtën edhe për votim në Republikën e Kosovës.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara .

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
A nr. 156/2021 më datën 25.08.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.